

1. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018

1.1. Operacione të tregut të hapur

Tab.1: Banka e Shqipërisë - Shprehje të tregut të hapur (në miliardë lekë¹)

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO njëditore
05-Jan-18		21.72		
11-Jan-18		22.08		
17-Jan-18			3.19	
18-Jan-18		29.40		
24-Jan-18			6.40	
25-Jan-18		28.32		
01-Shk-18		26.21		
08-Shk-18		19.75		
15-Shk-18		21.69		
20-Shk-18			2.28	
22-Shk-18		22.33		
23-Shk-18				5.07
26-Shk-18			5.50	
01-Mar-18		24.12		
08-Mar-18		16.24		
15-Mar-18		20.04		
21-Mar-18	5.59			
23-Mar-18	6.30	22.83		
26-Mar-18			7.33	
29-Mar-18		22.88		

Në tremujorin e parë të vitit 2018, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacione të tregut të hapur për injektim likuiditeti. Në funksion të administrimit të portofolit të saj të bonove të thesarit, janë kryer në vijim edhe veprime në tregun sekondar të letrave me vlerë.


Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese, gjatë 3-mujorit të parë, ka qenë i ngjashëm me tremujorin e mëparshëm në rreth 41.30 mld lekë kundrejt 40.20 mld lekë, ndërsa ka pasur vetëm 1 operacion të tërheqjes së likuiditetit për 5.07 miliardë lekë. Shuma e injektuar është luhatur në një bandë të gjerë prej 34.00-48.20 miliardë lekësh. Faktori kryesor në rritjen e mungesës së likuiditetit në pjesën e parë të periudhës ka qenë ulja e portofolit të bonove të thesarit për shkak të maturimit të një emetimi nga Ministria e Financave dhe uljes së pjesëmarrjes të Bankës së Shqipërisë në një emetim 6-mujor dhe akumulimit të likuiditetit në llogarinë e qeverisë. Zëvendësimi gradual i portofolit në periudhën shkurt-mars, reduktimi i parasë në qarkullim gjatë periudhës për rreth 9 miliardë lekë, si dhe injektimi i likuiditetit në mënyrë të

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2018

përhershme nëpërmjet blerjeve të valutës nga sistemi bankar me objektiv rritjen e rezervave valutore, ulën nevojën për injektim, por që ka mbetur mesatarisht në nivele më të larta se 1 vit më parë.

Në funksion të menaxhimit më me efikasitet të mungesës së likuiditetit të sistemit bankar, Banka e Shqipërisë ka ruajtur injektimin nëpërmjet maturimeve të gjata në nivele të njëjta me 3-mujorin e kaluar në mesatarisht 18.20 mld lekë, duke qenë rreth 45% të injektimeve të përkohshme.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë (me vlerë nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Operacioni rregullues për injektim njëditor është përdorur në 2 raste në muajin mars, kundrejt 6 në tremujorin e kaluar, si dhe ka pasur 1 rast ku është përdorur operacioni i tërheqjes së likuiditetit në muajin shkurt.

1.2 Operacionet për menaxhimin e portofolit të Bankës së Shqipërisë

Në funksion të administrimit të portofolit të Bankës së Shqipërisë, gjatë 3-mujorit ka pasur 1 maturim të bonos së thesarit 6-mujore dhe ulje të pjesëmarrjes së Bankës së Shqipërisë në një emetim tjetër me maturim 6-mujor, për një total prej 4.556 miliardë lekësh, ndërkohë që janë blerë nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe dhe nëpërmjet ankandevë në total 3.30 miliardë lekë bono thesari 6 dhe 12-mujore. Gjendja e portofolit të h-BSSë në fund të muajit mars 2018, është 51.85 mld lekë, kundrejt 53.10 mld lekë në fund të vitit 2017.

1.3. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Bankat kanë përdorur depozitën në Bankën e Shqipërisë në 8 raste për shuma deri në 3 mld lekë, ndërsa kredia është përdorur në vetëm 2 raste për shumat 1.20 dhe 1.60 mld lekë.

2. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2018

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në përputhje me objektivin e rritjes së rezervave valutore, Banka e Shqipërisë në periudhën janar-mars 2018 ka organizuar 2 ankande të blerjes së valutës sipas skedulit të publikuar në muajin dhjetor 2017 dhe që paraqitet më poshtë.

Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2018		
	Data	Shuma Raundi I (në mln euro)
1	22/02/2018	3-6 mln
2	23/03/2018	3-6 mln
3	20/04/2018	3-6 mln
4	17/05/2018	3-6 mln
5	22/06/2018	3-6 mln
6	26/07/2018	3-6 mln
7	24/08/2018	3-6 mln
8	16/10/2018	3-6 mln
9	15/11/2018	3-6 mln
10	14/12/2018	3-6 mln

Në dy ankandet e organizuara në muajt shkurt dhe mars janë blerë 19.30 milionë Euro. Në të dy rastet, Banka e Shqipërisë ka përdorur opsionin e blerjeve në raundin e 2-të, sikurse parashikohet në rregulloren përkatëse².

Rezultatet e detajuara të të gjitha ankandëve të zhvilluara nga Banka e Shqipërisë mund t'i gjeni në link-un: https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

2.2 Veprime me institucione të tjera

Shuma e marrëveshjeve SWAP me Ministrinë e Financave ka qenë 35.70 miliardë lekë në fillim të muajit

²https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Operacionet_e_Bankes_se_Shqiperise/Nderhyrjet_ne_tregun_valutor/

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2018

janar deri në datën 27 shkurt dhe ka rënë në 25 miliardë lekë në fund të muajit mars.

Veprimet e Bankës së Shqipërisë me institucionet financiare të huaja dhe të vendit kanë qenë të ulëta, ku janë blerë 360 mijë USD nga IBRD, 759 mijë Euro projektit IPA të Ministrisë së Financave, si dhe i janë shitur 240 mijë Euro Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

[Shqiptaria.com]